

Karta e Problemeve Rinore

Ne të rinjtë e qytetit të **Shkodrës** nën moton "**Rinia Guxon**" kemi diskutuar në lidhje me problemet që na shqetësojnë të cilat duhet të kenë vëmendjen e çdo ekipi qeverisës.

Me dëshirën për tu mos u përdorur nga politika por që ta përdorim NE politikën për zgjidhjen e problemeve tona nëpërmjet debateve konstruktive përcaktuam prioritetet tona për të cilat kërkohet vëmendja e juaj që ti përfshini në programet dhe alternativat qeverisëse për zgjedhjet e pushtetit lokal të cilat janë si mëposhtë:

A. Hartimi i Planit Lokal per Rinine

B. Ngritja e një Qëndre MultifunkSIONALE Rinore

C. Krijimi i bizneseve inkubatore për rininë

D. Krijimi i programeve të specializuara për trajtimin e problemeve sociale të të rinjve

E. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit online

Ne duam që zëri ynë të dëgjohet për t'ju dhënë mbështetjen tonë!

Ne duam që problemet tona të marrin zgjidhje jo thjesht si përfitues por edhe si pjesë e zgjidhjes prandaj kërkojmë jo thjesht premtime por angazhim serioz nga të gjithë kandidatët për drejtues të pushtetit lokal të cilët i ftojmë të nënshkruajnë

me të rinjtë shkodranë kontratën sociale si instrumenti i angazhimit të tyre publik dhe i mbështetjes sonë!

Ftojmë të gjithë të rinjtë e qytetit të Shkodrës që ti bashkohen nismës sonë që së bashku të marrim në dorë fatet tona dhe të bëhemi pjesë e qeverisjes së qytetit tonë!

Zëri Juaj duhet të dëgjohet sepse "Rinia Guxon"

A. Hartimi i Planit Lokal te Veprimit per Rinine

Per te rritur pjesmarrjen e te rinjve ne vendimarrje eshte e rëndesishme qe Bashkia Shkoder te kete nje plan te qarte veprimi ku te pasqyrohet sa me qarte menyra dhe rruget e angazhimit te te rinjve ne vendimarrje si dhe permiresimi i cilesise se tyre te jeteses. Per kete qellim eshte nevojte urgjente qe Bashkia Shkoder se bashku me aktore tjere lokale te interesuar per te mbeshtetur te rinjte te angazhohet ne hartimin e planit lokal per Rinine.

Per kete qellim duke u mbeshtetur edhe ne ligjin Nr.8652, datë 31.7.2000 **PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE** neni 3 per nxitjen efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore dhe ne te drejten e saj bazuar ne nenin 8 eshte e rëndesishme qe te konsolidohet praktika e mire e krijuar ne Bashkine Shkoder per ngritjen e Bordit Rinore. Ky Bord do te sherbeje si promotor kryesore ne nxitjen e politikave rinore ne qytetin e Shkodres duke u fokusuar kryesisht ne ceshtjet e meposhtme:

Pjesmarrja Rinore.

Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes në aspektin e çështjeve dhe interesave të lidhura me të rinjtë.

Informimi Rinor.

Vendosja e mekanizmave (ose kanaleve) për informim të të rinjve në nivel lokal.

Edukimi.

Përmirësimi i kualitetit të përgatitjes arsimore të të rinjve me qëllim gjetjen më të shpejt të punës ose hapjes së biznesit individual.

Punesimi Rinor.

Rritja e bashkëpunimit dhe informimit mes Bashkise, shkollave, shoqatave dhe të rinjve në drejtim të nxitjes së vullnetarizmit te të rinjtë dhe nxitja e të rinjve në realizimin e projekteve dhe programeve të drejtuara në punësimin.

Zmadhimi i mundësive për punësim dhe vetëpunësim të rinisë përmes harmonizimit të ofertës dhe kërkesës së tregut të punës.

Kultura dhe Sporti.

Përkrahja për angazhim kulturorë, krijimtari dhe inkuadrim më masiv të rinisë në aktivitetet kulturore përmes informimit të përmirësuar / përkatës dhe lidhjes në rrjete të faktorëve nga fusha e kulturës dhe rinisë.

B. Krijimi i nje qendre rinore multifunkionale

Kryeqendra e veriut Shkodra me nje perberje popullsie 114.000 banoresh ku pjesa me e madhe jane te rinj ku duhet qe ti jap nje rendesi te vecante pjesmarrjes se te rinjve ne vendimarrje duke i ofruar hapsira dhe lehtesite e nevojshme. Sipas ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE", vecanarisht sipas nenit 8, njesite e qeverisjes vendore mund te krijojne struktura administrative per kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga praktika te vendeve te tjera perendimore si dhe ne qytete te tjera te Shqiperise ngritja e nje qendre rinore do te ishte nje mundesi e mire per ti dhene me teper fuqi zerit rinore.

Kjo Qender Rinore e ngritur nga Bashkia Shkoder do te permbushte kerkesat, nevojat dhe dëshirat rinore per mesim, argetim, edukim, integrim dhe gjetjen e rrugeve jetesore per nje te ardhme me te mire.

Kjo qender rinore do sugjeronim te kishte nje strukture gjithperfshirese nga grupe te ndryshme te rinjsh te cilet vijne nga shoqeria civile, forume politike, grupe vulnerable, minoritete etj duke qene e pavarur ne vendimarrje dhe duke u udhehequr vetem nga te rinjte.

Qendra do te synoje te gjalleroje pjesmarrjen e te rinjve ne fusha te ndryshme duke i kthyer ato ne promotor te zhvillimit te projekteve me perfitim jo vetem per te rinjte por edhe per komunitetin. Disa nga sugjerimet tona jane:

Ofrimin e Kartes se studentit, Karta e studentit eshte nje instrument tashme i ngritur ne shume vende evropiane e cila si praktike mund te zhvillohet edhe ne qytetin e Shkodres. Nepermjet kartes se studentit bashkohen interesat e komunitetit, Bashkise dhe sektorit privat duke perfituar te gjithe se bashku. Karta do jete nje promocion i sherbimeve te ofruara nga Bashkia dhe sektori privat dhe perfitues do te jete komuniteti i te rinjve te cilet do marrin sherbime me te lira. Nga ana tjeter perfitimi i bizneseve do jete sepse biznesi i tyre do te reklamohet drejpersdrejti tek mbajtesit e kartes.

Promovimi i Lidereshipit rinore dhe punes vullnetare, ku qendra mund te behet promotore per zhvillimin e aktiviteteve te ndryshme per te promovuar te rinj nga fusha te ndryshme.

Shkembimi informacioni qendra mund te behet promotore per shkembimin e informacionit tek te rinjte kryesisht ne fushen e tregut te punes duke i ofruar mundesi punesimi dhe duke u bere ure nderlidhese ndermjet punedhenesve dhe komunitetit te te rinjve.

Mundesit formimi profesional ku qendra do te ofroj informacion ne lidhje me trainime dhe programe edukimi kombetare dhe nderkombetare ku te rinjte mund te marrin pjese dhe te rrisin kapacitetet e tyre profesionale.

Promovimi i vlerave turistike dhe mbrotja e mjedisit te qytetit duke shkembyer informacion, ndertuar guida turistike, pergatitjen e animatoreve te rinj turistike.

Promovimin e projekteve kulturore dhe artistike brenda dhe jashte Shqiperise.

C.Krijimi i bizneseve inkubatore për rininë

Papunësia mes të rinjëve në ditët e sotme është në nivele alarmante, për këtë arsye lind nevoja e mbështetjes nga qeverisja vendore, duke ndërhyrë me politikat e saj për të zbutur këtë fenomen mjaft negativ. Nga të gjitha takimet e zhvilluara me të rinjte rezultoi se punësimi është shqetësimi kryesor që ato kanë. Ofrimi i mundësive për punësim për të rinjte jo vetëm që do përmirësonte statusin social-ekonomik të të rinjve por edhe do i jepte me tepër mundësi zhvillimit qytetit tone prandaj Bashkia duhet të kushtojë një vëmendje më të madhe punësimit të të rinjëve. Krijimi i kushteve lehtësuese për punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjëve do ishte një nxitje për këta të fundit. Të rinjte duhet të ofrohen me tepër kushte që të zhvillohet kreativiteti i tyre nepermjet iniciativave sipërmarresi të cilat do i jepnin një ritëm tjetër zhvillimit ekonomik të qytetit.

Kerkesa për të mbështetur rininë bazohet në hapsirat që ligji nr.8652, datë 31.7.2000 **“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”**, neni 72, pika III, i ka dhënë në fushën e zhvillimit ekonomik-vendor pushtetit vendor të cilat janë:

a) përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik -vendor;

b) ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe rrjeteve tregtare;

c) zhvillimin e biznesit të vogël, si dhe zhvillimin e veprimtarive nxitëse si panairë, reklama në vende publike etj;

ç) organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura përkatëse;

Prandaj duke u nisur nga nevoja e te rinjve per me shume mundesi punesimi dhe duke shfrytesuar hapsirat ligjore qe ekzistojne dhe pasi kemi grumbulluar nevojat, kerkesat dhe sugjerimet e te rinjve ne kërkojmë:

1. Krijimin e një zone me infrastrukturë të përshtatshme për hapjen dhe zhvillimin e bizneseve nga të rinjtë.

- *Ambjentet të ofrohen pa pagesë për një periudhë nga 1-2 vjeçare.*
- *Përrjashtimin nga taksat vendore të bizneseve që operojnë në këtë zonë.*
- *Të mbështeten bizneset e kësaj zone me konsulence profesionale juridike, ekonomike si dhe nga fusha të tjera.*

2. Krijimin e një fondi garancie nga Bashkia në mënyrë që të rinjtë të kenë lehtësira në marrjen e kredive tek Bankat e nivelit të dytë.

- *Të vendoset në dispozicion të një Banke të nivelit të dytë, e cila do të përzgjidhet me konkurs, një fond garancie jo më i vogël se 10 Milion Lekë.*
- *Të zhvillohen konkurse ku të rinjtë do kenë mundësinë të prezantojnë planin e tyre të biznesit, pranë një komisioni ekspertësh, në mënyrë që të përfitojnë nga ky fond.*

D. Krijimi i programeve të specializuara për trajtimin e problemeve sociale të te rinjte.

Sipas ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE” në nenin 11 të saj pika b) qeverisja vendore ka për detyrë të garantoj sistemin e shërbimit parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik;

Prandaj lind si domosdoshmeri ofrimi i programeve të specializuara për trajtimin e problemeve sociale për te rinjte. Në këtë kuader Bashkia Shkoder duhet të vendos në axhendën e saj këtë çështje si prioritet. Në si te rinj nga konsultat e zhvilluara dhe informacionet e grumbulluara kemi dalë me konkluzionin që për te lehtësuar këtë problem do të ishte mirë që pranë institucioneve arsimore dhe shëndetsore të krijoheshin “info point”/pika informimi për te rinj. Pranë këtyre qendrave punonjës social dhe psikolog si dhe te rinj të specializuara në fushat përkatëse të ofrojnë informacione falas në lidhje me

- a) *semundjet seksualisht të transmetueshme,*
- b) *rreziqet e abuzimit me alkolet dhe drogat e ndryshme,*

- c) *asistence psikologjike ndaj te rinjve te dhunuar ose me tendenca per tu perfshire ne kriminalitet*

Po ashtu eshte e domosdoshme te organizohen ne menyre periodike fushata sensibilizuese duke perdorur ne menyre sa me te shumte mjete te informimit publik te tilla si:

- a) *Poster dhe fletpalosje*
- b) *Realizimi i video spoteve sensibilizuese*
- c) *Shfaqja e tyre ne ambjente rinore si shkolla, universitete, OJF etj.*
- d) *Projektimi i mesazheve sensibilizuese ne ambjente publike*
- e) *Krijimi i eventeve artistike me qellim sensibilizimin e te rinjve*
- f) *Fushata sensiilizuese ne bashkpunim me Institucione te shendetit publik*

Po ashtu nje problem mjaft i spikatur i cili kerkon edhe rritjen e vemendjes se Bashkise eshte permiresimi i infrastruktures ne institucionet arsimore dhe edukuese. Ku si probleme kryesore te spikatura qe kerkohet vemendje jane

- a) *Per te rritur sigurine ne shkolla kerkohet qe te instalohen sisteme moderne te sigurise si sisteme te vezhgimit me kamera,*
- b) *sisteme qendrore te ngrohjes*
- c) *sisteme te mbrojtjes kundra zjarrit.*
- d) *Te sigurohet ndricimi i duhur i brendshem dhe i jashtem*
- e) *Te permiresohet cilesia e ambjenteve sportive dhe te krijohen ambjente sportive publike duke kerkuar qe cdo projekt ndertimore te perfshije edhe hapesira sportive dhe kulturore*
- f) *Te parandalohet futja me mjete te rrezikshme per jeten si nga personat qe skane lidhje me shkollat ose dhe atyre qe jane pjese e saj.*
- g) *Te rritet ndergjegjesimi i te rinjve dhe aktoreve te shoqerise per rrezikshmerine e perdorimit te alkolit dhe duhanit nga te rinjte.*

E. Zhvillimi i teknologjise së informacionit online

Të rinjtë e qytetit tonë përballen me problematika të shumta të cilat është e nevojshme që të kenë mbështetjen e pushtetit lokal. Duke qenë se vendi ynë është në rrugën e integritit drejt Bashkimit Evropian rezulton si domosdoshmëri që të zbatohen edhe në qytetin tonë praktikat më të mira të punës me të rinjtë. Si hallkë kryesore për promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve duhet të jetë zhvillimi i teknologjise se informacionit online” duke nxitur mobilitetin rinore dhe forcimin e kapaciteteve te të rinjve si dhe rritjen e mundesive për integrimin e tyre në shoqeri, në komunitetin lokal dhe më gjerë. Zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit online rezulton si një mënyrë e mirë dhe e lehtë për promovimin e vullnetarizmit ku të rinjtë mund të përfshihen

lehtësisht, të marrin pjesë, të diskutojnë, të angazhohen në aktivitete të ndryshme me karakter social kulturor, sportiv dhe artistik.

Bazuar në ligjin Nr.8652, datë 31.7.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE pushteti lokal në fushën e shërbimeve me karakter social, kulturor e sportiv ka keto kompetenca:

a) ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore dhe historike vendore, organizimin e veprimtarive dhe administrimin e institucioneve përkatëse;

b) organizimin e veprimtarive sportive, çlodhëse e argëtuese dhe administrimin e institucioneve përkatëse;

Prandaj duke shfrytëzuar këto hapësira ligjore ne kërkojmë:

1. Ngritjen e një platforme online e cila ka si qëllim:

a) Krijimin e një faqeje interaktive në internet ku çdo grup informal ose formal rinor mund të regjistrohet dhe të publikojë të gjitha nismat për mobilizimin e të rinjve, zhvillimin e vullnetarizmit në qytetin tonë,

b) Shkëmbimin e informacionit për mundësi formimi, edukimi, dhe punësimi.

2. Krijimin e një sporteli informativ rinor për shkëmbimin e informacionit më të gjithë komunitetin e të rinjve të qytetit dhe jashtë tij.

a) Dhënia e informacionit rreth aktiviteteve rinore në qytetin e Shkodrës, krijimi i një kalendari i cili do të paraqesë të gjitha këto aktivitete.

b) Dhënia e informacionit rreth aktiviteteve turistike në qytetin e Shkodrës, guida turistike, materiale promocionale si: harta, etj.

3. Përfshirja në programet evropiane për nxitjen e shkëmbimeve rinore ndërkombëtare me karakter social, artistik për promovimin e vlerave të qytetit.